

URDHËR
Nr. 387, datë 23.5.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 13, 20 dhe 23 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neneve 1 dhe 2 të ligjit nr. 7/2024, “Për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2017, ‘Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës’, të ndryshuar”, kapitullin IV, të VKM-së nr. 120, datë 6.3.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Mirela Thanasi, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Diasporës, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas VKM-së nr. 120, datë 6.3.2024, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

2. Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani